

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ Arion Investment ” sh.p.k.

Në Durrës, sot më datë 19.06.2024 (dymijë e njëzet e kater), personi fizik:

Z. Astrit Losha, atësia Destan, amësia Nadire, i lindur më 01.03.1985, në Koman, Shkoder dhe banues në Tirane, me adresë Rruga “Loni Ligori”, Pallati Viki, Nd. Ap.2, Shkalla B/5 shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet Pasaportes me Nr. BJ6062149 dhe Nr. personal I50301114D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Vendosi sa vijon:

NENI 1

Themelohet shoqëria tregtare : **“ Arion Investment ” Sh.p.k**

Ortaku themelues i saj është:

a) **Z. Astrit Losha 100%.**

Shoqeria tregtare **“ Arion Investment ” Sh.p.k**, do të jetë shoqëri me përgjegjesi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë do të jetë i stampuar dhe ne vulën e saj.

NENI 2

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Durrës, Lagjja Nr. 13 Rruga Pavaresia, Zona kadastrale 8518, numer pasurie 38/264/ND+1-31.

NENI 3

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit. Me vendim të ortakut, mund të krijohen ose anullohen (në rast se janë çelur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqiperise dhe jashtë saj. Njësítë e tjera strukturore të shoqerisë si degë apo përfaqësi edhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.



NENI 4 **Kapitali i shoqërisë**

1. Kapitali fillestari i shoqërisë është 100 000 lekë. Pjesemarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është 100 % i kapitaleve të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Astrit Losha** është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltarë të shoqërisë.

Shoqëria mund të ndryshojë kapitalin themeltar; Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë;

Po kështu transferimi i Kuotave bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe përgjithësisht siç parashihet në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve.

Ortaku ka të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 5

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është me një afat të pacaktuar.

NENI 6

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashegimie, në përputhje me ligjin dhe statutin.

NENI 8

Shoqëria “ **Arion Investment** ” sh.p.k. krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë:

Rikonstruksione objektesh te ndryshme, perfshire vila, apartamente, shitjen/blerjen dhe dhenien me qira te tyre, ndertime objektesh te ndryshme, punime te ndryshme civile, ndermjetesime ne fusha te ndryshme dhe bashkepunime me investitor te huaj dhe zyra juridike (avokatie, noteriale) Shqiptare etj.

Përveç veprimitarive të parashikuara më lart në veprimtarinë sipermarrese të shoqërisë do të hyjë çdo veprimitari tjeter industriale, tregtare, financiare dhe qe do të konsiderohet nga ortaku e nevojshme dhe e përshtatshme për arrijen e objektit të shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga ligji.

NENI 9

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarëvajtjen e shoqërisë.



NENI 10

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjera, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me shoqëri tjeter tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 11

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi me i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i njeh asamblesë së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortakët mund t'ia delegojnë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë.

NENI 12

Administratori i Shoqërisë do të jetë:

Z. Astrit Losha, atësia Destan, amësia Nadire, i lindur më 01.03.1985, në Koman, Shkoder dhe banues në Tirane, me adresë Rruga "Loni Ligori", Pallati Viki, Nd. Ap.2, Shkalla B/5 shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet Pasaportes me Nr. BJ6062149 dhe Nr. personal I50301114D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori i shoqërisë, Z. **Astrit Losha**, emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij akti.

NENI 13

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 kopje originale, me të njëjtën vlerë ligjore, një kopje depozitohet në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

Ky akt u lexua dhe u kuptua nga nënshkruesi i cili deklaron se akti është i rregullt tërësisht dhe në çdo paragraf në përputhje me vullnetin e lirë e të plotë të tij, jep pëlqimin për sa përmendet në akt dhe nënshkruan rregullisht në çdo faqe dhe emër, mbiemër dhe firmë në mbyllje të aktit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISË TREGTARE

" Arion Investment " sh.p.k.

Astrit Losha

